

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

O EVLAD I DASHUR

Imam Ebu Hamid Muhammed al-Gazali

Prishtinë, 2019

Titulli i origjinalit:

Ejjuhel Veled

Përgatiti dhe përktheu:

Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:

Shenaj Zeneli

Një i ri i ndoqi për një kohë të gjatë mësimet e dijetarit të madh islam Ebu Hamid Muhamed ibn Muhammed el Gazali, dhe kështu fitoi dituri të mjaftueshme dhe e zhvilloi nevojën dhe ndjenjat për vlera e virtyte shpirtërore. Një ditë, nxënësi filloi t'i rishikojë dhe shqyrtojë dituritë e fituara, e konkludoi:

I studiova thuj se të gjitha dituritë dhe e harxhova lulen e rinisë duke mësuar. Tani më duhet ta di se cila dituri do të më shërbejë më së miri për të ardhmen dhe për jetën pas vdekjes, dhe cila dituri nuk më sjellë dobi e t'i largohem. Resulallahu s.a.v.s., shpesh ka thënë:

- O Allah, tek Ti kërkoj strehim nga dituria që nuk më sjellë dobi!

Prandaj djaloshi vendosi t'i shkruajë letër Imam Gazalit dhe të kërkojë këshillë nga ai. Duke iu drejtuar mësuesit të tij, djaloshi e ceku që veprat e Gazalit, siç është *Ihjau ulumid-din* e të tjerat¹ i përmbajnë përgjigjet në pyetjet e tij, por që ky është i dobët, dhe dëshiron që Imami t'i përgjigjet shkurtë, qartë e dobishëm, në një letër, që këtë ta ketë gjithmonë me vete dhe që me të të veprojë gjatë gjithë jetës. Si përgjigje, Imam Gazali i shkroi nxënësit të tij.

¹ *'Kimijja es-Sa'ada'* (Alkimia e suksesit dhe lumturisë finale), *'Xhavahir ul-Kur'an'* (Xhevahirët e Kur'anit), *'Arba'een'* (Katërdhjetë hapat), *'Minhaxh ul 'Abedin ila Xhannatu Rabbul 'Alemin'* (Rruga më e mirë e adhuruesvetë Allahut, që i dërgon drejt xhennetit të Rabbittë botëve).

Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Hamdi i takon vetëm Allahut, Rabbit të gjithë botëve, salat dhe selam zotërisë së njerëzimit, Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit, as'habëve të tij të ndershëm dhe atyre që pasojnë ahlakun dhe sunnetin e tij.

O evlad i dashur dhe shok besnik!

Allahu Teala të dhashtë jetë të gjatë për të adhuruar dhe për t'iu nënshtruar urdhrave të Atij, dhe të dhashtë që të ecësh rrugës së të dashurve të Tij.

Dije se të gjitha këshillat e mira janë marrë nga Resulallahu s.a.v.s., e themel i tyre janë Hadithet dhe Sunneti. Nëse ke marrë ndonjë këshillë nga Hadithet e Sunneti, atëherë nuk të duhet këshillë nga unë. E nëse nuk ke marrë ndonjëherë nga këshillat e Resulallahut s.a.v.s., atëherë ma thuaj, gjithë këto vite, çfarë diturie ke marrë nga unë?

Sido që të jetë, dëgjo:

Duke e këshilluar ummetin, Resulallahu s.a.v.s., mes tjerash, ju tha:

“Për atë që merret me punët që nuk i takojnë dhe nuk i sjellin dobi, kjo është shenjë e qartë se Allahu Teala e ka larguar rahmetin e Tij nga ai. Dhe nëse robi e harxhon qoftë edhe një orë nga jeta e vet në tjetër prej asaj për çka Allahu e ka caktuar, është i denjë për fatkeqësi të madhe. Dhe kush i arrinë të katërdhjetat, e veprat e mira nuk i janë më të shumta se të këqijat, le të përgatitet për xhehenem!”

O evlad, kjo këshillë ju mjafton atyre që kuptojnë.

Këshillimi është i lehtë, por veprimi sipas këshillës jo, sidomos jo për atë që udhëhiqet me epshe dhe që në zemër i dominojnë dëshirat e veta të ulëta. Atij këshilla i vjen e idhët dhe e rëndë, sepse zemrën e ka të zënë në kurthin e kënaqësive të dynjasë.

Njëjtë është edhe me atë që mëson për të arritur pozitë dhe pasuri të dynjasë. I tilli mendon se dituria është në vetvete shpëtim e mirësi, dhe që dituria e liron atë nga veprimin dhe angazhimi.

Kjo është bindje dhe mendim i të padijshmëve. O Allah, hamdi të takon Ty! Ky i mjerë nuk e di se dituria pa veprim nuk jep kurrfarë dobie dhe që ai, me hutinë e vet, po punon kundër vetes. A nuk e di ai se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Dënimin më të ashpër në ditën e Gjykimit do ta marrë dijetari i cili nuk ka përfituar nga dituria e Allahut.”

Tregohet se një i urtë e ëndërroi Xhunejd Bagdadin (rahmetullahi alejh), pas vdekjes së tij, e i tha:

- *O Ebu Kasim! Më trego për gjendjen tënde pas vdekjes!; në çka Xhunejdi tha:*

- *Shkuan fjalët e u zhdukën shenjat. Pata dobi vetëm nga reقاتet që i falja natën vonë.*

O evlad , mos rri i pa-punë por as mos bëj punë të padobishme, dhe dije sigurt që dituria pa veprim nuk sjell dobi në Ditën e Gjykimit. Dituria pa veprim është sikur shembulli i atij që përballet me luanin dhe është i armatosur me shpata të mprehta, shtizë të mirë e armë tjera, di t’i përdorë ato dhe është i guximshëm. E nëse në moment e sulmon luani, e ky nuk i përdorë armët, si mund të shpëtojë? Ti e di që ai nuk do të shpëtonte. Njëjtë, pa marrë parasysh sa dituri posedon personi, nëse nuk vepron sipas asaj diturie, nuk do të ketë dobi.

Shembull tjetër: nëse një mjek sëmuret dhe ai e di se shërimin e ka në filan ilaç, por nuk e përdorë ilaçin; a mundet atë t'a shërojë dituria për ilaçin dhe aftësia e ilaçit për ta shëruar, nëse nuk e përdorë? Prandaj mund ta kuptosh mirë se posedimi i njohurisë nuk i shëron sëmundjet e brendshme.

Poeti thotë:

*Edhe me dymijë litra ilaç të furnizohesh,
nëse nuk e pi - nuk do të shërohesh.*

Ti mund të mbledhësh shumë dituri e vazhdimisht të lexosh libra, por me këtë nuk e meriton rahmetin e Allahut. Rahmeti i Allahut meritohet vetëm me vepra.

Dëgjo, Allahu Teala thotë:

“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar.” 53-Nexhm: 39

E çfarë thua për këto ajete të Kur'anit:

“E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.” 99-Zelzele: 7, 8

dhe:

“Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet.” 18-Kehf: 110

si edhe:

“Me të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të shpërblehen me kopshtet e Firdeusit, ku do të qëndrojnë përherë, duke mos dëshiruar asnjë ndryshim.” 18-Kehf: 107, 108

E Allahu Teala në Kur’an gjithashtu thotë:

“Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mire.” 25-Furkan: 70

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

"Islami ndërtohet në pesë shtylla: dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi a.s., është i dërguar i Allahut; falja e namazit; dhënia e zekatit; haxhxi dhe agjërimi i Ramazanit."

Imani i ka tri pjesë: të thuhet me gjuhë, të besohet me zemër dhe të shfaqet me veprim. Nëse mendon se unë po them që robi i Allahut do ta fitojë xhennetin me veprat e tija të mira, atëherë kuptoje që nuk më ke kuptuar.

Përkundrazi, ajo çfarë po them është se robi i Allahut do të hyj në xhennet vetëm me rahmetin e Allahut. Por, robi duhet të përgatitet për rahmetin e Allahut me ibadet dhe me përshtatje urdhrave të Tij:

“Vërtet, rahmeti i Allahut është afër punëmirëve.”

7-Araf: 56

Pra, si do të hyjë robi i Allahut në xhennet, pa rahmetin e Allahut Teala? Po e përsëris këtë pikë të rëndësishme: si do të hyjë robi i Allahut në xhennet, pa mëshirën e Allahut Teala? Nëse dikush thotë se robi do të hyj në xhennet për shkak të imanit të vet, ta dish se ka shumë vështirësi përpara. Mes tyre, vështirësia e parë - si e bartë ai imanin e vet? Se veprimi është pjesë e imanit tregojnë dëshmi të shumta. Hasan Basriu (rahmetullahi alejh) ka thënë:

“Ditën e Gjykimit, Allahu Teala u thotë robëve të Tij:

- Hyni në xhennet me mirësinë Time, dhe ndajeni atë mes vete sipas veprave tuaja!”

O evlad, dije se vetëm nëse punon, do të shpërblehesh; tregohet se njëri nga Izraelitët bëri ibadet për shtatëdhjetë vite, e për t’ju treguar melekëve gjendjen e tij, Allahu e dërgoi një melek dhe e urdhëroi që t’i shpallë se ai me ibadetin e vet nuk e ka fituar xhennetin.

Në vend që të dëshpërohet, ai tha:

- *Detyra ime është të bëj ibadet, e Allahu vendos.*

Kur meleku u kthye te Allahu, tha:

- *O Allah, Ti më së miri e di se çfarë u përgjigj ai.*

Në këtë, Allahu Teala tha:

- *Kur ai nuk hoqi dorë nga ibadeti, as Ne nuk do ta largojmë atë nga rahmeti Ynë. O melekët e mi, bëhuni dëshmitarë që Unë ia fala atij të gjitha gjynahet!*

Dëgjo çfarë ka thënë Omeri r.a., në një hutbe:

“Shqyrtoni punët tuaja dhe jepni llogari vetes (deri sa jeni) në dynja para se të jepni llogari në ahiret, peshoni veprat tuaja para se ato të peshohen në ahiret.”

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Ai që mendon se pa mundim e veprim mund të fitojë xhenneti, ai vetëm mashtrohet, e ai që mendon se vetëm me mundim e veprim mund të fitojë xhennetin, duhet të angazhohet me vështirësitë e ibadetit.”

Në këtë kuptim, Hasan Basriu ka thënë:

‘Të dëshirohet dhe kërkohet xhenneti nga Allahu Teala pa veprim, është gjynah.’

Hasan Basriu gjithashtu ka thënë:

“Dëshmi e të vërtetës është veprimi pa u lavdëruar, e jo mos-veprimi.”

Zotëria jonë në të dy botët, Resulallahu s.a.v.s., e thotë më pastër e më bukur:

“I mençëm është ai që interesohet dhe punon për kohën pas vdekjes (ahiret), përderisa budalla është ai që ndjekë dëshirat e veta e kërkon nga Allahu Teala xhennetin.

O evlad i dashtun, sa netë i kalove duke lexuar e studiuar gjithë ato libra! Nuk e di çka mund të ketë qenë arsye për këtë, mirëpo nëse gjumin e ke sakrifikuar për të arritur pozitë të lartë, pasuri dhe epërsi ndaj shokëve tu, mjerë ti, dhe prapë, mjerë ti! E nëse me këtë ke për qëllim të forcosh dhe të ringjallësh diturinë e lartësuar të Islamit, të përhapësh ahlakun dhe ta refuzosh e ta thyesh epshin që dërgon vetëm kah e keqja, në atë rast – lum për ty!

Të vërtetën e ka thënë poeti:

*Netët pa gjumë, nëse nuk janë për Ty,
janë të kota,
Loti e vajtimi nëse s’janë për Ty,
janë të kota.*

E në hadith thuhet:

“Dashuro çfarë të duash, në fund do të ndahesh. Vepro si të duash, në fund do të përgjigjesh. Jeto sa të duash, në fund do të vdesësh.”

A e di ti çfarë dobie ke nga filozofia, kelami, mjekësia, letërsia, astrologjia, metrika, gramatika e sintaksa? T'i studiosh vetëm këto dituri, do të ishte harxhim kot i jetës tënde. Përkundrazi, të mendosh për Allahun Teala dhe t'i përshtatesh urdhrave të Tij, ky është kuptimi i vërtetë i jetës.

Në Ungjill e kam parë këtë shprehje të Isasë a.s.:

"Nga momenti kur i vdekuri vendoset në tabut, e deri sa të sjellet te varri, Allahu Teala do t'i kërkojë përgjigje në katërdhjetë pyetje. Pyetja e parë e Allahut do të jetë:

- O robi Im, me vite tentove të zbukurosh pamjen tënde të jashtme për njerëzit, e pamjes tënde ndaj Meje nuk i kushtove as një orë kujdes. Unë për çdo ditë shikoja në zemrën tënde, e të thosha: 'Të kam rrethuar me të gjitha mirësitë e Mia, e ti punon për tjetrin! Mos je i shurdhër, e nuk më dëgjon?!'

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu nuk i shikon fytyrat tuaja dhe trupat tuaj, por Ai i shikon zemrat e juaja.”

Resulallahu s.a.v.s., na ka treguar evlad, se për çdo ditë, zëri i Allahut tingëllon në zemrën tënde:

“O robi Im! Përse më adhuron Mua vetëm për mburrje e lavdërim, kur edhe e mira edhe e keqja janë në dorën Time? Prandaj, vetëm Mua më adhuro, me nijet të sinqertë e devotshmëri, e jo që të ju pëlqesh krijesave të Mia të vdekshme, që nuk janë në gjendje as të ndihmojnë e as të dëmtojnë, pos me lejen Time.”

Dituria pa vepra është çmenduri, e vepra pa dituri as nuk mund të ndodhë. Të jesh i sigurt se vetëm dituria nuk është në gjendje që sot të të largojë nga veprat e këqija, e as të të udhëzojë në ibadet, e as nesër të të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Nëse sot nuk punon sipas diturisë tënde dhe nuk mundohesh të kompenzosh atë që të ka ikur në ditët e shkuara, nesër do të thuash:

- *O Allah, na kthe në dynja, të bëjmë vepra të mira;*
- por atëherë do të marrësh përgjigjen:
- *Budalla, ti nga atje erdhe!*

O evlad i dashur, vepro që të kesh zemër të madhe e fisnike, dhe që e epshi yt të mos e shpallë fitoren, e trupin ta kesh të vdekur. Shtëpi e jotja është varri yt. Ata që tashmë kanë shkuar atje, po të presin në çdo moment. Prandaj kujdes e mos shko atje pa furnizim.

Ebu Bekr r.a., ka thënë:

“Trupat janë kafezë për zogj ose shtalla për bagëti.”

Mendo cilit lloj i takon ti. Nëse je nga zogjtë e sferave më të larta, atëherë në thirrjen e burisë:

- ***Kthehu te Rabbi yt!***, do të dalësh nga kafazi e të ngritesh në lartësitë e pallateve të xhennetit, ashtu siç ka treguar Resulallahu s.a.v.s.:

- ***Kur vdiq Muadhi, u dridh Arshi i Rahmanit.***

E nëse, Allahu na ruajt, i takon llojit të atyrëve për të cilët Allahu Teala (7-Araf: 179) thotë:

“Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi”, dije se do të largohesh nga *‘shtalla’* jote, për në xhehenem.

Tregohet se Hasan Basriut ia ofruan një gotë ujë, të kthjellët e të ftohtë, dhe sa e mori në dorë, ra pa vetëdije. Kur erdhi në vete dhe e pyetën për sebeb, Hasani tha:

- *M’u kujtua vajtimi i banorëve të xhehenemit, kur do të lusin banorët e xhennetit për pak ujë.*

Allahu Teala thotë:

“A ka dikush të pendohet për gjynahe? A ka dikush të kërkojë diçka nga Unë? A ka dikush të më lusë për falje?,

e sikur të mjaftonte dituria pa veprim, kjo shpallje do të ishte pa vlerë. Në fakt, kjo shpallje e Allahut Teala në agim është për:

“...disa robë të Allahut, që flejnë pak në pjesën e fundit të natës (pak para agimit, kohë e bekuar për t’iu afruar Allahut).”

Tregohet se me një rast as’habët e lavdëruan Abdullah ibn Omerin në prani të Resulallahut s.a.v.s., e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Është njeri i mirë; e sikur t’i kalonte edhe netët në ibadet!

Resulallahu s.a.v.s., i tha njërit prej as’habëve:

- Mos flejë shumë natën, sepse kush fle shumë, mbetet i varfër në ditën e Gjykimit!

T’i lutesh Allahut natën është urdhër i Allahut Teala:

“Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të (me Kur’anin - namazin), është e sigurt se Zoti yt do të ngrejë ty në një vend të lavdishëm.” 17-Isra: 79

e Allahu është mirënjohës për këtë veprim:

“...(dhe që) kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” 3-Ali Imran: 17

Të kërkosh falje nga Ai në mëngjes do të thotë t'i jesh falënderues, i nënshtruar dhe besnik Atij. E zotëria jonë në të dy botët, Resulallahu s.a.v.s, ka thënë:

“Allahu Teala i do tre zëra: zërin e gjelit (sepse njerëzit ngriten për namaz të sabahut), zërin e atij që lexon Kur’an dhe zërin e të devotshmit kur kërkon falje në pjesën e fundit të natës.”

Sufjan Sevri ka thënë:

“Allahu Teala ka krijuar një lloj të erës që fryn në pjesën e fundit të natës, dhe i bartë te Krijuesi zërat e robëve të Tij, që përmendin Allahun (zërat e dhikrit) dhe e lusin për falje”;

dhe thotë:

“Kur të fillojë nata, një melek nën Arshin e Allahut e bën lajmërimin që të zgjohen të gjithë të devotshmit, prandaj ata që ju është dhënë takva nga Allahu, ngriten dhe nisin të falen. Në gjysmë të natës, një melek tjetër bën lajmërimin që të zgjohen të gjithë abidët. Ngriten edhe këta dhe falin namaz deri para agimit (imsak). Kur vjen koha e imsakut, meleku i tretë bën lajmërimin që të zgjohen ata që kërkojnë faljen prej Allahut, prandaj këta ngriten dhe kërkojnë falje prej Allahut. Kur agon, atëherë meleku i katërt bën lajmërimin:

*- O ju të pavëmendshëm, zgjohuni!
e këta ngriten nga shtrati, sikur i vdekuri kur të ngritet nga varri në ditën e Gjykimit.”*

Tregohet se Llukmani i urtë e këshilloi të birin:

- *Mos lejo që gjeli të jetë më i mençur se ti! Ai gjithmonë ngritet para agimit dhe e lajmëron kohën për namaz, kurse ti fle.*

Sa bukur e ka thënë dikush:

*Mes i natës, unë në gjumë,
zogu në degë dhikr po bon,
Pasha Beitin, unë gënjeva,
në vaj zogu ma kalon.*

*Unë u betova edhe thashë
se Krijuesin shumë e dua,
por ja që kafshët qajnë, vajtojnë,
e një lot s'më doli mua!*

O evlad, esenca e diturisë është *ibadet* dhe *itaat* (nënshtrim). Dhe dije se *ibadet* dhe *itaat* është përshtatje urdhrave dhe ndalesave e Allahut Teala dhe Resulallahut s.a.v.s., me veprim e me të folur; që do të thotë se gjithçka që thua dhe vepron, duhet t'i nënshtrohet rregullave të Sheriatit. Nëse flet, fol përshtatshëm mësimëve të Resulallahut s.a.v.s., dhe nëse hesht, hesht përshtatshëm mësimëve të tij. Nëse vepron, vepro përshtatshëm mësimëve të Resulallahut s.a.v.s., dhe nëse nuk vepron, mos vepro - përshtatshëm mësimëve të tij.

Nëse ti e bën një veprim dhe e konsideron si ibadet, por nuk je duke e bërë për t'ju nënshtruar urdhrave të Resulallahut s.a.v.s., atëherë kjo nuk llogaritet si ibadet; përkundrazi – do të llogaritet gjynah, qoftë edhe namaz a agjërim.

Nëse agjëron ditën e Bajramit, ose ditët e haxhit, atëherë je gjynahqar, ani pse veprimi ka formë të ibadetit, por në ato ditë nuk është në pajtim me urdhrat e Resulallahut s.a.v.s., dhe ky mospajtim e bën personin gjynahqar.

Njëjtë ai që falë namaz në kohë të ndaluar ose në vend të uzurpuar pa të drejtë; ai është gjynahqar dhe shkelës i rregullave, meqenëse këto veprime nuk janë përshtatshëm udhëzimeve të Resulallahut s.a.v.s., ani pse në dukje përngjasojnë me ibadet. E nëse burri ka marrëdhënie intime me gruan, kjo nuk është gjynah, ani pse duket si veprim i tillë. Por, pasi bëhet në pajtim me udhëzimet e Resulallahut s.a.v.s., atëherë është hallall.

Po kuptohet se ibadeti nuk është vetëm falje e namazit dhe agjërim por, ibadet do të thotë përshtatje urdhrave e fesë. Sepse namazi dhe agjërimi janë ibadet kur bëhen përshtatshëm urdhrave të fesë.

Prandaj evlad, është e domosdoshme që fjalët dhe veprat tua t'i përshtaten urdhrave të fesë, sepse dituria dhe veprimi, nëse nuk janë përshtatshëm Sheriatit, paraqesin thjesht hutit. Mos u mashtro me çfarëdo fjale të dervishëve. Tasavvufi - tarikati i vërtetë, nuk është aty. Tasavvufi është drejtim që arrihet vetëm përmes xhihadit kundër epsheve dhe kërkesave trupore, dhe aty rolin kryesor e ka *rijazet* (kundërshtim i dëshirave të nefsit; mposhtje e nefsit me qëllim të edukimit të tij) e jo me magji e fjalë të zbukuruar. Deri sa të mos kundërshtosh dhe të edukosh nefs, zemra nuk do të të ndriçohet me dritën e njohjes. Dhe dije, fjalët e bukura e zemra mbushur me pakujdes e epshe, janë shenjë e një fatkeqësie të madhe.

Në disa pyetje tjera prej teje më ishte e pamundur që të përgjigjem përmes shkrimit, ose edhe me gojë. Kur të arrish në aso grada, do t'i kesh edhe përgjigjet. Ato gjendje nuk përshkruhen me fjalë. Është sikur të provosh të njohësh të ëmblën dhe të idhëtën përmes fjalëve, e pa i shijuar. E për pyetjet në të cilat mund të përgjigjemi, tashmë kam shkruar në "*Ihjau-ulumid-din*" dhe në veprat tjera. Por do t'i shpjegojmë edhe këtu, më shkurtimisht, inshallah;

Ti ke pyetur se cilat janë kushtet që i duhen udhëtarit të rrugës së drejtë:

1. Të ketë besim të drejtë (Ehli sunnet) dhe të mos përfshihet në bidat;
2. Të pendohet për gjynahet ashtu që të mos i përsërisë më, dhe që kurrë të mos bëjë vepër të keqe me qëllim;
3. Të mos i bëj padrejtësi as armikut; dhe
4. Të njohë rregullat e fesë aq sa i duhet për të kryer të gjitha obligimet fetare.

Atij i duhet të dijë se çfarë i është urdhëruar e çfarë ndaluar, çfarë duhet bërë e çka nuk guxon të bëjë. E nga dituritë tjera, duhet të mësojë aq sa do t'i mjaftojnë që të shpëtojë.

Shibliu ka thënë:

“Kam mësuar nga katërqind dijetarë dhe kam mësuar katërmijë hadithe. Mes tyre e zgjedha një, dhe sipas tij veprava. Hadithet tjera nuk m’u deshtën, sepse në hadithin e zgjedhur unë e gjeta shpëtimin dhe lumturinë time, dhe e pashë se ai hadith përmbante dituritë e gjeneratave të para e të fundit; Muhammedi alejhisselam ju tha as’habëve në një rast:

- Punoni për këtë botë aq sa do të jetoni në të. Punoni për botën tjetër aq sa do të qëndroni atje – përgjithmonë. Punoni për Allahun Teala aq sa juve ju nevojitet dhe, punoni për zjarrin - aq sa mund të duroni.”

Nëse e kupton këtë hadith, dhe vepron me të, nuk të duhet edhe shumë dituri tjetër. Mendo edhe për transmetimin në vazhdim, që të të shtohet bindja: Hatemul Esam ishte njëri nga nxënësit e Shakiki Belhit për tridhjetë e tri vite. Kur Belhiu e pyeti se çfarë mësoi prej tij gjatë kësaj kohe, ky iu përgjigj se i ka marrë tetë mësim. Imam Belhi u habit pse kaq pak, por megjithatë kërkoi t’i dëgjojë, e Esami filloi të tregojë:

(1) E pashë që çdokush ka një shok. Por, me qenë se të gjithë shokët në fund kthehen prej varrit, nuk i besova askujt dhe zgjodha veprat e mira për varrin, i vetmi që do të bëhet shoku im.

- Shumë mirë. Po tjerat?; tha Shakiki, e Esami vazhdoi...

(2) Mendova rreth ajetit:

“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Rabbit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin” (Nazi’at 79:40-41); *dhe e kuptova që është hak (e vërtetë), e frenova veten nga dëshirat, dhe vazhdova t’i përshtatem urdhrave të Allahut Teala.*

(3) *E pashë që secili e ruan pasurinë e vlefshme, e fshehin në arka, bëjnë gjithçka për mos ta humbur. Kurse Allahu Teala thotë:*

“Gjithçka që keni ju është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme” (Nahl 16:96). *Unë e mendova këtë ajet dhe për të mos humbur atë që e pashë të vlefshme, ekzistencën time ia bëra amanet Allahut dhe punova për përfitimin e kënaqësisë së Tij.*

(4) *E pashë që secili është duke kërkuar pasuri, famë, respekt dhe pasardhës. Kuptova që këto nuk janë asgjë, sepse Allahu Teala në këtë ajet urdhëron:*

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij” (Huxhuratë 49:13). *E pashë që pasuria nuk qenka nder dhe zgjedha devotshmërinë.*

(5) *E pashë që njerëzit vazhdimisht sulmojnë njëri-tjetrin, mallkojnë. Shkakun e kësaj e gjeta në xhelozit dhe mendova rreth ajetit:*

“Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë” (Zuhruf 43:32), *dhe e kuptova që kjo ndarje është ndarja e Allahut Teala, në këtë askush nuk mund të ndikojë. Iu dorëzova ndarjes së Allahut, sëmundjen e xhelozisë e hodha, dhe askujt nuk i bëra armiqësi.*

(6) *Pashë që njerëzit bëhen armiq të njëri-tjetrit, vrasin njëri-tjetrin. Allahu Teala në këtë ajet thotë:*

“Me të vërtetë, shejtani është armik për ju, andaj vështrojani si armik!” (Fatir 35:6). *Mendova, dhe kuptova që armiku i vërtetë është shejtani. Dhe unë vetëm shejtanin e konsiderova armik dhe askujt tjetër nuk i bëra armiqësi.*

(7) *E pashë që njerëzit për një kafshatë buke, pa u kujdesur se a është hallall a haram, durojnë çdo vështirësi. Allahu Teala thotë:*

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij” (Hud 11:6). *Pasi që edhe unë jam njëra nga këto gjallesa, e kuptova që për rizkun (furnizimin) tim Allahu Teala është garantues. I braktisa dëshirat dhe u drejtova në obligimet ndaj Allahut.*

(8) *Pashë që një pjesë e njerëzve besojnë dhe mbështeten në pasurinë dhe tregtinë e tyre; Unë mendova rreth ajetit të Allahut Teala:*

“Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.” (Talak 65:3), *dhe vetëm Allahut iu mbështeta. Për mua, Allahu Teala është i mjaftueshëm. Këto janë ajo çka mësova prej teje.”*

Shakiki tha:

“O Hatem, Allahu të shpërbleftë! E kam studiuar Teveratin, Inxhilin, Zeburin dhe Kur’anin, dhe po e shoh që të gjitha mirësitë janë të përmbledhura në këto tetë çështje. Kush i aplikon këto, ka aplikuar të katër Librat.”

* * *

O evlad , këto që t'i treguam sigurisht ta bëjnë të qartë që nuk të duhet dituri e tepërt, e tash t'i kthehemi kushteve, e të tregoj se çfarë tutje i nevojitet atij që nisët në Rrugën e Drejtë;

Mbi të gjitha, për udhëtarin e rrugës së ahiretit (*muridin*) është e domosdoshme të gjej një *shejh*, që do ta udhëzojë dhe që nga zemra do t'ia largojë veset e këqija dhe ta bëjë të virtytshëm dhe të moralshëm; shejhu është sikur bujku që i largon therrat dhe rrënjët tjera të dëmshme nga ara, ndërsa frutin e ushqen, që ta ketë të mirë e të bollshëm. Thirrja e shejhut është vetëm vazhdim i thirrjes së Resulallahut s.a.v.s.. Muhammedi a.s., u dërgua të udhëzojë njerëzit në Rrugë të Drejtë, e pas largimit të tij, a.s., nga kjo botë, mbetën halifet (përfaqësuesit) e tij, që tutje të tregojnë rrugën e drejtë për njerëzit, deri në ditën e Gjykimit. E për të qënë përfaqësues i pejgamberit, së pari duhet të jetë dijetar; ***alimët*** (dijetarët), ***janë trashëgimtarët e Pejgamberëve.***

Por, dituria nuk është kushti i vetëm, prandaj unë do t'i përshkruaj këtu cilësitë kryesore që duhet të posedojë shejhu, do të thotë trashëgimtari i Resulallahut s.a.v.s..

Këto duhet të njihen sepse ka shumë shejhë të rrejshëm, të cilët qëllim të vetëm kanë të mashtrojnë njerëzit për të përfituar materialisht prej tyre, e kështu, duke udhëzuar keq njerëzit i bëjnë dëm fesë. Dhe them se: *Shejh* mund të jetë vetëm ai që ia ka kthyer shpinën dashurisë për këtë botë, për respekt e për pozitë mes njerëzve.

Silsila e Shejhut duhet të arrijë deri te Muhammedi alejhiselam. Ai që e ka edukuar nefsin posedon ahlak të bukur, ushqehet me pak, flet pak, bën pak gjumë, falë shumë namaz, agjëron, jep sadaka. Krahas kësaj, ai posedon basiret të plotë dhe ahlak të bukur, si durimin (*sabr*), mbështetjen Allahut (*tevekkul*), bindjen (*jakin*), devotshmërinë (*takva*), modestinë, qetësinë shpirtërore, butësinë, përlësinë, turpin, besnikërinë, dinjitetin e shpresën; të gjitha këto janë cilësi që duhet të jenë me Shejhun, që të jetë i denjë t'a pasojnë. Shejhu duhet të ketë marrë nur nga nuri i Muhammedit a.s., në mënyrë që të gjitha cilësitë e këqija si koprracia, xhelozia, armiqësia, mbështetja dynjasë e banorëve të saj, zemërimi, etj, të jenë larguar nga ai, dhe ai nuk do të marrë dituri tjetër kah, përpos prej Resulallahut s.a.v.s..

Këto cilësi e bëjnë njeriun përfaqësues të Resulallahut s.a.v.s., dhe është e përshtatshme të pasohet një udhëheqës i tillë shpirtëror. Por, të këtillë ka pak. E, atij që i është dhënë e mira dhe takon shejh me cilësitë e përmendura, e shejhu e pranon, ky e ka obligim ta nderojë, edhe haptas edhe fshehtas. Haptas e nderon ashtu që përmbahet nga çfarëdo kritike apo debati me shejhun, edhe nëse mendon se shejhu ka gabuar. Sexhaden do ta shtrojë kur e ka nijet të falë namazet në kohë, e sapo ta kryejë namazin, do ta largojë sexhaden. Nuk duhet që në prani së shejhut të falë shumë nafile, dhe do të përpiqet të bëjë atë që shejhu e urdhëron, aq sa mundet. Nderim i brendshëm do të jetë që muridi të pranojë çfarëdo që dëgjon nga shejhu dhe nuk duhet ta kundërshtojë, as me fjalë e as me veprim. Duhet të largohet nga një situatë e tillë, nga frika prej dyfytërisë. Nëse nuk është në gjendje që mësuesit të vet t'i shprehë besnikërinë edhe haptas edhe fshehtas, atëherë më mirë le ta braktisë. Gjithashtu, obligim i atij që ka dëshirë të jetë udhëzues në rrugë të drejtë është që të evitojë shoqërinë e keqe, që zemra mos t'i largohet nga ndikimi i mësuesit të vet, ta pastrojë zemrën nga papastërtia dhe ta mbrojë nga mashtrimet e shejtanit të mallkuar, si edhe të zhvillojë dashurinë ndaj fukarallëkut, më shumë se sa ndaj pasurisë.

Kusht tjetër i domosdoshëm është që muridi ta ruajë veten nga mashtrimet e nefsit. Kjo është e mundur vetëm nëse muridi largohet nga tubimet e të padijshmëve. Në këtë mënyrë, ndikimit të shejtanit në zemrën e tij i vjen fundi, dhe të gjitha mashtrimet e shejtanit largohen me rrënjë.

Në çfarëdo situatë, udhëtari i ahiretit duhet të parapëlqejë modestinë dhe mungesën e lakmisë për pasuri, dhe do të duhej të përvetësojë pajtimin dhe kënaqjen me vendimin e Allahut. Këto janë kushtet themelore për udhëtarin në rrugë të Allahut Teala.

* * *

O evlad, ke pyetur për *tasavvuf*;

Tasavvuf është emërtim për dy cilësi:

1. *Cilësia e parë*, është që robi të jetë i nënshtruar singqertisht urdhrave të Allahut, pra të veprojë sipas sheriatit; dhe
2. *Cilësia e dytë*, është që të jetë i dhimbshëm dhe vepërmirë me të gjitha krijesat e Allahut.

Kjo është rruga e sufive, e cila nuk është e mundur pa pastrimin e zemrës prej cilësive të këqija dhe mbushjen e saj me të mira.

Prandaj, kush është i sinqertë e me ahlak të bukur ndaj të tjerëve, pa dyshim që është sufi. Besnikëria dhe nënshtrimi Allahut manifestohen me braktisjen e dëshirave, për rizanë e Allahut. Sinqeriteti ndaj të gjithë njerëzve shprehet me atë që, udhëtari i ahiretit nuk i mbanë lidhjet me njerëzit për interes të vetin dhe ruhet nga egoizmi. Përkundrazi, veten ia kushton të mirës së të gjithë njerëzve, me kusht që kjo e mirë duhet të jetë në pajtim me sheriatin.

Ke pyetur edhe për *itaat*;

Itaat - Nënshtrimi urdhrave të Allahut i ka tri pjesë:

1. *zbatim i urdhrave të shariatit*;
2. *nënshtrim dhe kënaqësi me përcaktimin e Allahut*;
3. *sakrifikim i dëshirave të veta për rizanë e Allahut*.

Ke pyetur për *tevekkul, ihlas dhe rija*;

Sa për *tevekkul*, mund të them që përbëhet nga besimi i fortë në atë që Allahu Teala e ka premtuar. Pra të besosh se do të arrish atë çfarë Allahu të ka caktuar, edhe nëse krejt bota i kundërvihet kësaj, dhe poashtu që, nuk do të mund të arrish atë çfarë Allahu nuk të ka caktuar, edhe sikur të gjithë njerëzit të të ndihmojnë.

ihlas - të jesh besnik dhe i sinqertë, do të thotë që të gjitha veprat të bëhen vetëm për rizanë e Allahut Teala, dhe me qëllim që të arrihet rahmeti i Tij, e jo të mendojë se a do ta lavdërojnë apo qortojnë njerëzit.

E dije mirë se *rija* (dyfytyrësia) vjen nga pëlqimi dhe lavdërimi prej njerëzve. Kësaj mund t'i iket vetëm me bindjen e plotë që të gjithë njerëzit i janë të nënshtruar caktimit të Allahut, dhe që nuk janë në gjendje të bëjnë dëm apo dobi pa lejen e Allahut. Nëse mendon se njerëzit janë të fortë, atëherë nuk mund të shpëtosh nga dyfytyrësia.

O evlad , disa prej pyetjeve tua i kemi shpjeguar në librat që i kemi shkruar dhe mund t'i gjesh atje, e të tjerat nuk është e përshtatshme të shpjegohen pa ardhë koha e tyre. Vepro me këto që t'i shpjeguar, e do t'i kuptosh edhe ato që nuk t'i shpjeguar. Pas kësaj, për çfarëdo çështje që të duket e vështirë e nuk e kupton, pyet vetëm me gjuhën e zemrës. Dhe kujto fjalët e Allahut Teala:

“E sikur të durojnë ata deri sa t’ju dalësh ti atyre, do të ishte më mirë për ta.” 49-Huxhurat: 5

Mbaje në mend edhe këshillën e Hizrit a.s., kur tha:

“Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, përderisa të mos ta shpjegoj unë!” 18-Kehf: 70

Prandaj mos u ngut me pyetje, kur të arrishë atë gjendje, do ta shohësh vet;

“Unë do t’jua tregoj shenjat e Mia, prandaj mos më kërkoni të ngutem.” 21- Enbija: 37

Dhe bindu se, po nuk u nise drejt asaj gjendje, nuk mund të arrish atje;

“A nuk udhëtojnë ata nëpër Tokë e a nuk shohin?”

O evlad , pasha Allahun, nëse udhëton dhe i shikon krijesat e Allahut, në zemër do të zbulohen gjëra të mrekullueshme! Duhet të angazhohesh, në secilin hap, përndryshe nuk arrin për ku je nisur. Kur të jesh gati të japësh edhe shpirtin; kjo është vepra më e mirë. Zunnun Misri iu drejtua njërit prej nxënësve të vet:

“Nëse je në gjendje të japësh edhe shpirtin, eja. Përndryshe, largohu.”

O evlad , prano nga unë edhe tetë këshilla, nëse nuk dëshiron që në ditën e Gjykimit dituria jote të bëhet armiku yt. Sipas katër prej tyre duhet të veprosh, e katër tjerat të tregojnë çfarë duhet braktisur:

Katër këshillat se çfarë duhet braktisur

KËSHILLA E PARË

Provo që sa më pak të diskutosh e debatosh për çfarëdo qoftë. Në to ka më shumë dëm se dobi. Ato janë burim i të gjitha cilësive të këqija si dyfytërsia, lakmia, mendjemadhësia, urrejtja, armiqësia, lavdërimi e të ngjashme. Por, nëse në praninë tënde diskutohet për diçka, dhe ti e sheh se pa ty e vërteta nuk do të dalë në pah, në atë rast të lejohet që të përfshihesh në diskutim me qëllimin e vetëm që të ndihmohet në fitoren e së vërtetës. E për këtë ka dy tregues:

a) ti dëshiron të thuhet e vërteta, qoftë nga ti apo nga kundërshtari yt; dhe

b) më me dëshirë diskuton i tërhequr, se para botës.

Por, nëse po debaton për një çështje të caktuar, dhe ti je i bindur që ke të drejtë dhe që tjetri po debaton vetëm për t'u fjalosur, atëherë jepi fund atij diskutimi menjëherë, përndryshe lindin zilia dhe ofendimet, e kurrfarë hajri nuk del. Ta shpjegoj hajrin:

të pyesësh është sikur t'i tregosh mjekut për të sëmurin, e përgjigja është angazhimi i mjekut që i sëmuri të shërohet. Të padijshmit janë të sëmurë, e dijetarët janë mjekë. Dijetari i dobët nuk di të shërojë mirë, ndërsa dijetari i vërtetë e shëron atë që kërkon shërim dhe për të cilin mendon se mund të shërohet.

Nëse sëmundja është kronike dhe e pashërueshme, e gjithë aftësia që i nevojitet mjekut do të jetë të shohë padobinë e shërimit, që të mos harxhojë kohën kot. Padituria është sëmundje shumë e rrezikshme dhe është katër llojesh. Vetëm një lloj është i shërueshëm, e tri të tjerat nuk ka kuptim të shërohen:

Lloji i parë. Ky është ai që pyet nga zilia ndërsa ia kthen shpinën diturisë nga urrejtja. Zilia është sëmundje e pashërueshme. Në këtë as nuk duhet përgjegjur, sepse, edhe nëse i jep përgjigjen më të qartë e më të mirë, me këtë vetëm sa e shton urrejtjen e tij, armiqësinë dhe zilinë e tij. Për të këtillët është thënë:

“Secila armiqësi është e kalueshme, pos asaj nga zilia; ajo nuk kalon.”

Më së miri është të lihen që tutje të vuajnë nga kjo sëmundje, ashtu siç thotë Allahu Teala:

“Braktise dhe mos u brengos për atë që Neve na ka harruar e që kërkon vetëm kënaqësitë e kësaj bote.”

Me gjitha çka bën e çfarë flet ziliqari, vetëm sa e ndezë zjarrin e cila shkatërron frutin e punës së tij. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Zilia i shkatërron veprat e mira, si zjarri që i djegë drutë.”

Lloji i dytë. Ky është budallallëku dhe njëjtë është sëmundje e pashërueshme. Isa alejhisselam ka thënë:

“Kam mundur të ngjallë të vdekurin, me lejen e Allahut, por e kisha të pamundur të shëroj budallanë.”

Budalla konsiderohet ai që kalon pak kohë duke kërkuar dituri, e mendon se s’ka më të dijshëm. Lehtë lëshohet në debate dhe merr guxim e i kundërshton edhe dijetarët më të mëdhenj, që kanë kaluar jetën duke kërkuar dituri. Ky mendon se çka nuk di ai, nuk di askush. Edhe këtij lloji të njerëzve është budallaki t’i përgjigjesh.

Lloji i tretë. Ky është personi që dëshiron të mësojë, dhe vetëm për këtë qëllim edhe pyet, mirëpo është aq i padurueshëm, sa edhe përkundër përgjigjes më të mirë, nuk mund ta kuptojë të vërtetën, por kupton vetëm aq prej të cilës ka interes. Edhe këtij më mirë të mos i përgjigjet. Muhammedi alejhisselam ka thënë:

“Neve pejgamberëve, na është urdhëruar që njerëzve t’ju flasim aq sa ata mund të kuptojnë.”

Lloji i katërt. Padituria si sëmundje që shërohet është padituria e të sëmurit i cili pa kurrfarë inati, zilie a dëshira të ulëta dëshiron të arrijë dituri, pandaj edhe pyet, jo nga inati, por për shkak të dashurisë që e ka për diturinë. Një i sëmurë i këtillë duhet shëruar dhe duhet përgjegjur pyetjeve të tij.

KËSHILLA E DYTË

Duhet të largohesh sa më shumë ose fare mos të pranosh shërbimin e vaizit. Misioni i vaizit është shumë i ndjeshëm, është plot rreziqe, dhe njeriu nuk mund ta pranojë, përpos me kushtin që të veprojë ashtu si flet. Në këtë kuptim iu tha Isasë a.s.:

- Fillimisht këshilloje veten, e nëse vet e pranon atë këshillë, atëherë këshillo edhe të tjerët, e nëse jo, turpërohu nga Unë.

Por nëse ndodh e të duhet të mbash vaz, atëherë kujdes nga dy gjëra:

a) Ruaju nga ngurtësia në të folur, nga vargjet e paqarta e dykuptimëshe e nga zbulurimi i fjalëve, sepse kjo mënyrë e të shprehurit vjen nga zemra e shpërndarë. T'i tërhiqet vërejtja dikujt do të thotë t'i kujtohen tmerret e zjarrit të xhehenemit dhe t'i kujtohet mangësia e tij në falënderim Allahut, dhe të nxitet në mendim për jetën që e ka harxhuar kot dhe për pengesat që i ka në rrugë, siç është frika nga përfundimi i dobët i jetës në këtë botë dhe frika nga dobësimi i imanit kur të jepet shpirti. Njeriu duhet të mësohet të mendojë se a do jetë në gjendje të kalojë urën e Siratit, apo do të rrokulliset në xhehenem, si edhe të mendojë për gjendjen e vet në ditën e gjykimit.

Njeriu duhet t'i ketë në mendje të gjitha këto çështje dhe të mendojë për to, ashtu që kur të mendojë, zemra t'i dridhet e të shqetësohet. Të shkaktohet një gjendje e këtillë te njeriu do të thotë t'i tërhiqet vërejtja. Ndërsa të mbashë vaz do të thotë ta njoftosh njeriun me këto, që ai të njohë mangësitë e veta në kryerje të detyrave dhe që menjëherë të mbushet mend e të mundohet të kompenzojë atë që i ka ikur. Vaizi do të mundohet të jetë sa më i kuptueshëm, njëjtë sikur ai që, kur sheh se ndonjë shtëpi po rrezikohet nga vërshimet, ngutet t'i alarmojë banorët e saj; as nuk mund të imagjinohet që ky të përdorë sarkazëm, dhe njëjtë as vaizi nuk guxon të shërbehet me aso shprehje.

b) Nuk është mirë që dëshirë e jotja të jetë të mbledhësh rreth vete sa më shumë dëgjues dhe që ata, duke i grisur rrobat të shprehin dashurinë ndaj Allahut, ndërsa qëllim i joti i vërtetë të jetë që ata të flasin se sa të bukur e ke zërin e sa vaiz i mirë që je. Një sjellje e këtillë është prirje e pastër për dynjallëk, e kjo vjen nga pakujdesia. Përkundrazi, ti do të duhej që njerëzit t'i largosh nga dynjallëku e t'i udhëzosh të bëhen gati për ahiret, t'i jenë të nënshtruar urdhrave të Allahut dhe të mos ngarendin kah kënaqësitë e dynjasë, të jenë bujarë e të devotshëm sepse ata sipas natyrës janë të prirë të bëjnë atë që është në kundërshtim me sheriatin dhe me ahlakun e mirë.

Prandaj frikësoi dhe tërheqju vërejtjen në pasojat e këqija, që të përmirësohen e të ndalojnë veten nga gjynahet. Vetëm kjo mund të quhet vaz. Të tjerat janë larg prej vazit, dhe janë më shumë të dëmshme se të dobishme, prandaj ato duhet ndaluar dhe të mos lejohen njerëzit t'i dëgjojnë.

KËSHILLA E TRETË

Mos u shoqëro me sundimtarët, as me të tjerë zyrtarë nga rangjet e larta të kësaj bote, sepse një shoqërim i tillë fshehë shumë rreziqe. Por, nëse je i detyruar në këso shoqërimi, mos i lavdëro e as mos u lut për jetë të gjatë për ta, sepse me këtë shkaktohet hidhërimi i Allahut:

“Vërtetë që Allahu Teala hidhërohet kur lavdërohet keqbërësi (fasiq) apo zullumqari (zalim), dhe ai që lutet për jetë të gjatë të zullumqarit është sikur ta pëlqejë faktin se ai është në këtë botë gjynahqar.”

KËSHILLA E KATËRT

Mos prano kurrfarë dhurate nga sundimtarët a shërbyesit e tyre, edhe koftë ajo nga hallalli, sepse ato dhurata janë shumë të rrezikshme. Të bëjnë të varur e të vendosin në pozitë të palakmueshme.

Sado të jesh i fortë, nuk do të shpëtosh nga dëshira që të përfitosh prej tyre apo të mos humbasësh afërsinë e tyre, dhe që assesi të mos i kundërshtosh. E ky është rrezik për imanin. Dëmi më i vogël do të ishte se ai që e pranon dhuratën menjëherë ta pëlqejë personin që e jep dhuratën. E meqenëse kur e do dikë, atij i dëshiron jetë të gjatë, në rastin tonë nënkupton t'i dëshirosh jetë të gjatë zullumqarit. Të dëshirohet kjo është sikur të dëshirohet dhuna dhe shkatërrimi. E po të pyes, a ka për imanin e një personi diçka më të dëmshme? Ruaju nga kurthet dhe mashtrimet e shejtanit!

Mos ju beso atyre që të thonë se më mirë është të pranohet dhurata nga sundimtari, e më pas t'ju ndahet nevojtarëve, me arsyetimin se ti po e harxhon në të mirë e padyshim se ata do ta harxhonin në punë të këqija. Të gjitha këto fjalë janë mashtrim; shejtani me vesvese të këtilla është bërë sebeb që shumë njerëz të humbin kokën. Për këtë më gjerësisht flitet në *Ihja ulumid-din*, prandaj lexo për këtë çështje atje.

Pra, ndale veten nga këto katër që i përmendëm, e katër janë edhe ato që duhet domosdo t'i bësh, prandaj do të ishte mirë të kesh kujdes me to:

Katër këshillat që të udhëzohesh

KËSHILLA E PARË

Ndaj Allahut vepro ashtu si do të dëshiroje të veprojë shërbëtori yt ndaj teje. Atë që nuk do që shërbëtori yt ta bëjë për ty, as ti mos e bëj për Allahun, Pronarin tënd të vërtetë. Duhet të mbashë në mend faktin se ti nuk e ke krijuar shërbëtorin tënd, por vetëm e ke punësuar atë. Ndërsa ty të ka krijuar Pronari yt, ti je pronë e Tij, prandaj obligimi yt që të mos shkaktosh pakënaqësi te Pronari yt, qoftë me mendime, fjalë ose vepra, është shumë më i madh.

KËSHILLA E DYTË

Kur t'i veprosh ndaj tjetrit, mendo sikur ai po vepron me ty ashtu, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Njeriu nuk e ka imanin e plotë derisa të mos i dëshirojë tjetrit atë që ia dëshiron vetes.”

KËSHILLA E TRETË

Kur dëshiron të shtosh diturinë e të lexosh, mendo një herë sikur nuk do të jetosh më shumë se një javë, e në atë situatë, mendo se cila dituri të sjell dobi. E dobi do të kesh nga dituria që ta përmirëson zemrën dhe e zbukuron ahlakun tënd.

Prandaj, ti sigurisht që për atë kohë nuk do të merreshe me studimin e fikhut, kelamit, poezisë, filozofisë e të ngjashme, sepse ti e di se nga to nuk do të kesh dobi, por do të merreshe me përmirësimin e zemrës dhe ahlakut. Ndërpreji lidhjet me këtë botë, pastroje zemrën nga cilësitë e papëlqyera dhe fillo me dashuri të adhurosh Allahun Teala. Njeriu mund të vdes në secilin çast, prandaj është e domosdoshme që gjithmonë të përgatitet për vdekjen. O evlad, dëgjo edhe diçka, mbaje në mend, kuptoja esencën, mendo për të dhe vepro me të, që kështu të jesh i sigurt se do ta fitosh shpëtimin: sikur të të japin lajmin se mbreti do të vizitojë javën tjetër shtëpinë tënde, atëherë ti gjithsesi se tërë javën nuk do të bëje punë tjetër pos që do të mendoje si të përgatitesh për vizitën. Gjithë kohën do të zbukuroje e rregulloje vendin ku mendon se do të bjerë shikimi i mbretit.

Fillimisht do të pastroje trupin tënd, do të veshje rroba të reja e më të mirat, do ta rregulloje shtëpinë e shumë përgatitje tjera... Ti e di se çfarë dua të them. Mendo për këtë! Sepse ti je i zgjuar, e për njeriun e zgjuar, një fjalë është e mjaftueshme.

Mbaji në mend fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Allahu nuk e shikon dukjen tuaj të jashtme, as veprat tuaja, por i shikon zemrat tuaja dhe qëllimet tuaja.”

Nëse dëshiron ta njohësh zemrën dhe gjendjet e saj, lexoje *Ihja Ulumid-din* dhe veprat tjera të mia, sepse njohja e zemrës është detyrë e secilit mysliman (*farzi-ajn*). Njohuritë tjera, përpos atyre që mësojnë se si bëhen ibadetet, janë obligime shoqërore (*farzi-kifaje*).

KËSHILLA E KATËRT

Mos grumbullo pasuri më shumë se që të nevojitet për një vit, për ty dhe familjen. Ashtu vepronte edhe Resulallahu s.a.v.s.. Ai shpesh thoshte:

‘Allah, dhuroi ummetit tim vetëm aq sa i nevojitet që të mund t’i mbulojnë nevojat e tyre. Le të mos kenë as më pak as më shumë se kaq!’

Resulallahu s.a.v.s., i siguronte me furnizim për një vit vetëm ata nga ummeti i tij për të cilët e dinte se nuk janë aq të fortë në besim, dhe që në zemër kanë ndonjë dobësi, derisa ata që ishin të fortë në imanin e tyre, ju siguronte furnizim vetëm për një ditë, ose gjysë dite.

O evlad, me kaq kryesisht u përgjigja në pyetjet tua. Tash duhet të mbledhësh guxim e të veprosh sipas përgjigjeve.

Ti më kërkove të të shkruaj edhe një dua, e duatë kërkoi në librin e Haditheve, sidomos në Sahih, dhe mësoi përmendësh. Përndryshe, tek ne kanë mbërrijtë shumë dua edhe nga ehli-bejti, prandaj kërkoi edhe ato. Lexo edhe duanë që po ta shkruaj në fund të kësaj letre; lexoje shpesh, sidomos pas namazit, e mos më harro në dua:

O Allah, nga Ti lus për bereqet të plotë, mbrojtje të vazhdueshme nga gjynahet, pastërti të përhershme e mëshirë gjithëpërfshirëse, shëndet, rehati dhe lumturi në jetë, mirëbërje të vërtetë, bereqet të përgjithshëm, mirësi dhe edukatë. O Allah, bëhu me ne, e mos na largo nga rahmeti Yt dhe mos na shkatërro. Përfundoi me lumturi jetët tona, plotësoi dëshirat tona të pastra, na dhuro shëndet kur nisemi e kur kthehemi, kur zgjohemi e kur shkojmë në gjumë, na udhëzo me rahmetin Tënd, lësho faljen Tënde mbi gjynahet tona, bëj që të përmirësohemi, që devotshmëria të na jetë furnizimi kryesor, që të angazhohemi për fe e të ngritemi, dhe në Ty të mbështetemi! O Allah, na forco në rrugë të drejtë dhe drejtësi, na largo nga punët për të cilat do të pendoheshim në ditën e Gjykimit nëse ne i bëjmë, na furnizo me furnizimin e të zgjedhurve, largoje nga ne të keqen e njerëzve të këqij, na ruaj neve nga zjarri, dhe ruaj baballarët tanë, nënat tona, vëllezërit dhe motrat! Na e prano duanë, pashë mëshirën Tënde, o Ti që je i Gjithëmëshirshmi, Ti që falë, që je Mëshirues. Ti i di të gjitha dhe je i Plotëfuqishmi, i Pari dhe i Fundit, i Fuqishëm dhe i Mëshirshëm! Nuk ka tjetër përpos Teje! Vetëm Ty të adhurojmë! Shpëtimi qoftë mbi Muhammedin alejhisselam, familjen e tij dhe të gjithë shokët të tij! Amin!

Kjo libër përfundoi me ndihmën e Sunduesit Absolut (*al-Malik*) dhe Falësit të Madh (*el-Gafur*).

